



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

#### Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 5.3.2020

#### Dokument parlamentar

#### Komision përgjegjës

### R A P O R T

**PËR DEKRETIN NR. 11979, DATË 24.2.2021, TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS, “PËR KTHIMIN E LIGJIT NR. 16/2021 “PËR RATIFIKIMIN E NDRYSHIMIT TË MARRËVESHJES SË KONCESIONIT NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHOQËRISË KONCESIONARE “TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT”, SH.P.K., “PËR NDËRTIMIN, VËNIEN NË PUNË, OPERIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E AEROPORTIT NDËRKOMBËTAR “NËNË TEREZA”, TIRANË”, RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 9312, DATE 11.11.2004, TË NDRYSHUAR””**

#### **I. HYRJJE.**

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 5 mars 2020, shqyrtoi dekretin nr. 11979, datë 24.02.2021, të Presidentit të Republikës, “Për kthimin e ligjit nr. 16/2021 “Për ratifikimin e ndryshimit të marrëveshjes së koncesionit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqërisë Koncesionare “Tirana International Airport”, sh.p.k., “Për ndërtimin, vënien në punë, operimin dhe mirëmbajtjen e Aeroportit Ndërkombëtar “Nënë Tereza”, Tiranë”, ratifikuar me ligjin nr. 9312, datë 11.11.2004, të ndryshuar””. Ky dekret është propozuar në mbështetje të neneve 85 pika 1 dhe 93 të Kushtetutës. Dekreti u shqyrtua në përputhje me rregullat e përcaktuara në nenet 32-38 dhe 86 të Rregullores së Kuvendit.

Komisioni caktoi relator, për këtë dekret, z. Anastas Angjeli.

Sipas nenit 86 të Rregullores së Kuvendit, dekreti për kthimin e ligjit për rishqyrtim futet automatikisht në programin e punës së Kuvendit. Dekreti u bë pjesë e rendit të ditës në mbledhjen më të parë të Komisionit për Ekonominë dhe Financat. Komisioni e shqyrtoi dekretin vetëm për çështjet e paraqitura në arsyetimin për kthimin e ligjit nga Presidenti i Republikës.

Shqyrtimi i dekretit në Komisionin për Ekonominë dhe Financat dhe dorëzimi i raportit të këtij Komisioni u bënë brenda 4 javëve nga data e depozitimit të tij në Kuvend (dekreti është

depozituar në Kuvend në datën 26 shkurt 2021 dhe afati për dorëzimin e raportit të Komisionit është brenda datës 26 mars 2021).

Për të pasur një mendim sa më profesional për çështjet e parashtruara në dekret, Komisioni mori mendimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të cilat janë ministritë proponente të projektligjit në Këshillin e Ministrave, si dhe kanë bashkëpunuar ngushtë me Komisionin për Ekonominë dhe Financat gjatë shqyrtimit të tij në Kuvend. Këto ministri janë në rolin e Operatorit Shtetëror të Autorizuar lidhur me marrëveshjen e koncesionit. Gjithashtu, Komisioni për Ekonominë dhe Financat u mbështet edhe në mendimin e paraqitur në raportin e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut për këtë projektligj.

Në mbledhjen e Komisionit ishin të pranishëm, për të dhënë mendime mbi dekretin dhe informacione të kërkuara nga deputetët:

*Nga Presidenca:*

- Z. Bledar Dervishaj, Këshilltar i Presidentit për Çështjet Ligjore;
- Znj. Katrin Treska, Drejtore e Përgjithshme e Shërbimeve Juridike në Institucionin e Presidentit të Republikës.

*Nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë:*

- Znj. Belinda Balluku, Ministre;
- Znj. Viola Haxhiademi, Sekretare e Përgjithshme;
- Z. Enea Karakaçi, Drejtor i Drejtorisë Juridike.

*Nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë:*

- Znj. Vasilika Vjero, Zëvendësministre;
- Z. Edmond Ahmeti, Drejtor i Drejtorisë së Koncesioneve.

## **II.BAZA LIGJORE PËR SHQYRTIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS**

### **Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë:**

Neni 85

1. Presidenti i Republikës ka të drejtë ta kthejë ligjin për rishqyrtim vetëm një herë.
2. Dekreti i Presidentit për rishqyrtimin e një ligji e humbet fuqinë, kur kundër tij votojnë shumica e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

### **Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë:**

Neni 86

Dekreti i Presidentit të Republikës për rishqyrtim ligji

1. Kur Presidenti i Republikës, në përputhje me nenin 85 të Kushtetutës, rikthen ligjin për rishqyrtim në Kuvend, Kryetari i Kuvendit e kalon menjëherë atë për shqyrtim në komisionin

përgjegjës që e ka shqyrtuar fillimisht. Dekreti i Presidentit për rishqyrtim ligji futet automatikisht në programin e punës së Kuvendit.

2. Dekreti për kthimin e ligjit për rishqyrtim bëhet pjesë e rendit të ditës të mbledhjes më të parë.

3. Komisioni përgjegjës e shqyrton dekretin vetëm për çështjet e paraqitura në arsyetimin për kthimin e ligjit nga Presidenti i Republikës.

4. Komisioni përgjegjës përgatit raportin për seancën plenare me propozimin për pranimin ose rrëzimin e dekretit të Presidentit brenda 4 javëve nga data e depozitimit të tij në Kuvend. Në rastin e pranimit të dekretit, raporti përmban formulimet për nene të veçanta të ligjit.

5. Dekreti për kthim për rishqyrtim të ligjit bëhet pjesë e rendit të ditës të seancës plenare, por jo më parë se 48 orë.

6. Seanca plenare e shqyrton dekretin për kthim për rishqyrtim të ligjit vetëm për arsytet e kthimit të tij.

7. Kuvendi në seancë plenare voton me shumicën e kërkuar në Kushtetutë për pranimin ose rrëzimin e dekretit.

8. Në rast pranimi të dekretit, Kuvendi voton në parim propozimet që komisioni përgjegjës ka paraqitur në raport. Kuvendi voton vetëm nenet që reflektojnë propozimet e miratuara në komision, si dhe bëhet votimi në tërësi për ligjin.

9. Ligji i votuar në tërësi mban numrin që ka marrë me miratimin e parë, kurse data do të jetë e votimit më të fundit në tërësi.

### **III. ARSYET PËR KTHIMIN PËR RISHQYRTIM TË LIGJIT SIPAS DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS.**

Dekreti nr.11 979, datë 24.02.2021 shoqërohet me arsyetimin përkatës për kthimin e ligjit. Në këtë arsyetim theksohet se ligji nr. 16/2021 i është përcjellë Presidentit të Republikës në datën 9.2.2021. Presidenti i Republikës shqyrtoi përmbajtjen e këtij ligji dhe të marrëveshjes së ratifikuar prej tij, duke iu referuar:

- Ligjit nr. 16/2021 dhe përmbajtjes së akt marrëveshjes ndryshuese, të miratuar prej tij;
- Praktikës parlamentare të publikuar në faqen e Kuvendit të Shqipërisë;
- Informacionit të administruar nga Kuvendi, Këshilli i Ministrave, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, pas kërkesës shkresore të Institucionit të Presidentit të Republikës; si dhe
- Informacionit zyrtar të institucioneve respektive publike.

Në arsyetimin e dekretit theksohet se marrëveshja ndryshuese e kontratës së koncesionit bie ndesh me disa parime e dispozita kushtetuese, siç janë:

- Parimi i lirisë së veprimtarisë ekonomike, i përcaktuar në nenin 11, pika 1 të kushtetutës;
- Parimi i barazisë para ligjit, i përcaktuar në nenin 18, pika 1 të kushtetutës;

- Neni 83, pika 2 e kushtetutës lidhur me procedurën e përshpejtuar të shqyrtimit të projektligjit.

Gjithashtu, sipas arsytimit të dekretit, ligji shmang edhe zbatimin e kërkesave të disa ligjeve të tjera, siç janë ligji për noterinë, ligji për mbrojtjen e konkurrencës, ligji për miratimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë, Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë.

Argumentet për kthimin e ligjit, sipas Presidentit të Republikës, janë si më poshtë:

**Argumenti 1.** Negocimi me shoqërinë koncesionare dhe miratimi i shtesës së kontratës koncesionare është miratuar me urgjencë dhe shpejtësi.

**Argumenti 2.** Nënshkrimi i shtesës së kontratës përpara noterit në Kamëz, jashtë territorit të Bashkisë Tiranë, është në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”.

**Argumenti 3.** Procedura e ndjekur bie në kundërshtim me parashikimet e Kodit Zgjedhor dhe të akteve të dala në zbatim të tij.

**Argumenti 4.** Zgjatja e afatit të kontratës përbën ndryshim të një kushti thelbësor të kontratës bazë dhe kërkon kryerjen e një procedure të re të dhënies me koncesion.

**Argumenti 5.** Ndryshimi i kontratës nuk i është nënshtruar një analize ligjore, financiare dhe ekonomike.

**Argumenti 6.** Zgjatja e afatit të kontratës koncesionare është bërë pa një analizë mbi seriozitetin, aftësinë menaxhuese dhe qëndrueshmërinë financiare të shoqërisë që ka blerë aksionet e infrastrukturës së vetme funksionale aeroportuale ndërkombëtare në vend.

**Argumenti 7.** Zgjatja e afatit të kontratës koncesionare nuk ka marrë në analizë objektive interesin publik lidhur me sigurinë kombëtare.

**Argumenti 8.** Vendosja, përmes ligjit, e autorizimit për marrjen e huave, duke lënë kolateral aksionet e shoqërisë, e vë para një rreziku të shtuar potencial të gjithë funksionimin e këtij shërbimi, përkundrejt sigurisë kombëtare.

**Argumenti 9.** Marrëveshja duhet të përfshinte në klauzolat e saj ndalimin e shoqërisë koncesionare, të parashikuar në marrëveshje apo të një shoqërie tjetër të lidhur me të, direkt a indirekt, për të konkurruar dhe fituar të drejta të tjera koncesionare, me qëllim shmangien e pozitës dominuese.

#### **IV. Diskutimi në Komision.**

Z. Anastas Angjeli, në cilësinë e relatorit, e kundërshtoi dekretin e Presidentit të Republikës, bazuar në këto argumente kryesore:

*Së pari, lidhur me pretendimin e dekretit se projektligji është shqyrtuar nga Kuvendi me urgjencë, duke shkelur Rregulloren, relatori shprehu mendimin se:*

Komisioni për Ekonominë dhe Financat harton kalendarin e punimeve të tij dhe përcakton rendin e ditës në përputhje me Kalendarin e Punimeve të Kuvendit, të miratuar nga Konferenca e Kryetarëve. Projektligji është përfshirë në rendin e ditës së këtij Komisioni të datës 4 shkurt

2021, bazuar në vendimin nr.2, datë 27.1.2021, të Konferencës së Kryetarëve “Për miratimin me mirëkuptim të Kalendarit të Punimeve të Kuvendit për periudhën 8-26 shkurt 2021”. Në këtë vendim, Konferenca e Kryetarëve ka përfshirë në kalendarin e punimeve të Kuvendit, ndër të tjera, edhe këtë projektligj. Ky vendim është miratuar me mirëkuptimin e përfaqësuesve të grupeve parlamentare dhe të kryetarëve të komisioneve të Kuvendit, të pranishëm në mbledhje. Komisioni për Ekonominë dhe Financat nuk ka shkelur asnjë procedurë të parashikuar në Rregullore, por e ka zbatuar me përpikmëri atë.

*Së dyti, lidhur me pretendimin se zgjatja e afatit të marrëveshjes së koncesionit është bërë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr.125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar, i cili kërkon kryerjen e një procedure të re, relatori ishte i mendimit se:*

Marrëveshja ndryshuese e koncesionit është në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit nr.125/2013. Në nenet 30 dhe 31 të këtij ligji përcaktohet se afati i kontratës mund të zgjatet në rastet kur ndryshon situata reale ose ligjore për përdorimin e objektit apo ofrimin e shërbimeve. Ndryshimet në kontratë mund të bëhen me iniciativën e të dyja palëve kontraktore. *Ndryshimet e kushteve thelbësore të kontratës, që nuk parashikohen në dokumentacionin e tenderit dhe/ose në vetë kontratën, kërkojnë zbatimin e një procedure të re të dhënies së kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat.*”

Gjithashtu, marrëveshja ndryshuese e koncesionit është në përputhje edhe me marrëveshjen bazë, të ratifikuar me ligjin nr. 9312, datë 11.11.2004. Në nenin 7 të këtij ligji përcaktohet se afati i kontratës mund të zgjatet në marrëveshje me shoqërinë koncesionare, për aq kohë sa kërkon kryerja e ndryshimeve të pranueshme. *Organi Shtetëror i Autorizuar dhe Shoqëria, duke njoftuar me shkrim njera-tjetrën, pas 5 viteve nga data e fillimit, por jo më vonë se 12 muaj para mbarimit të afatit të koncesionit, fillojnë procesin e negociimit për zgjatjen e afatit fillestar të koncesionit.*”

Pra, si ligji për koncesionet dhe partneritetin publik privat, ashtu edhe marrëveshja bazë e koncesionit, e parashikojnë afatin si një si një element që mund të ndryshohet dhe zgjatet dhe jo si kusht thelbësor, për të cilin palët do të detyroheshin të bënin një procedurë të re. Për këtë arsye, procedura e kryerjes përmes marrëveshjes ndryshuese, që bazohet në marrëveshjen midis dy palëve kontraktore për zgjatjen e afatit të marrëveshjes së koncesionit, është plotësisht në përputhje me kriteret ligjore.

*Së treti, lidhur me pretendimin se marrëveshja e koncesionit shkel parimet kushtetuese të lirisë së veprimtarisë ekonomike, barazisë para ligjit, si dhe është në kundërshtim me disa ligje të tjera, si ligjin për noterinë, Kodin Zgjedhor etj, relatori shprehu mendimin se:*

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, gjatë shqyrtimit të projektligjit, u mbështet edhe në vlerësimin e paraqitur nga Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, si komision i specializuar për çështjet e kushtetueshmërisë dhe të ligjshmërisë, si dhe i caktuar nga Konferenca e Kryetarëve në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi. Në raportin e këtij Komisioni për projektligjin theksohet se:

“*Në aspektin ligjor, projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjisllacionin në fuqi.*

*Në aspektin procedural*, projektligji është në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.”.

Mbështetur në këtë vlerësim, edhe Komisioni për Ekonominë dhe Financat e konsideron projektligjin të përputhur me kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

*Së katërti*, lidhur me pretendimin e dekretit se zgjatja e afatit të kontratës koncesionare është bërë pa një analizë mbi seriozitetin, aftësinë menaxhuese dhe qëndrueshmërinë financiare të shoqërisë, si dhe shoqërohet me risqe potenciale në funksionimin e shërbimit aeroportual, relatori kërkoi një informacion më të plotë nga Zëvendësministria e Financave, si kryetare e grupit të punës për negociimin e marrëveshjes së koncesionit. Zëvendësministria e Financave dhe Ekonomisë argumentoi qëndrueshmërinë financiare të shoqërisë dhe të investimit të kryer prej saj, sipas marrëveshjes ndryshuese. Argumentet për këtë çështje paraqiten si në fjalën e përmbledhur të Zëvendësministres së Financave dhe Ekonomisë, ashtu edhe në analizën e detajuar mbi dekretin, si më poshtë.

*Së pesti*, lidhur me përdorimin e shprehjes “korrupsion legjislativ” nga përfaqësuesit e Presidencës, relatori theksoi se:

Kjo është një terminologji e papërcaktuar nga kushtetuta dhe përdoret për etiketimin e veprimtarisë së një organi kushtetues, siç është Kuvendi dhe Komisionet e tij. Anëtarët e Komisionit kanë marrë pjesë në mbledhjet për shqyrtimin e projektligjit dhe askush nuk ka deklaruar përfitime ekonomike apo interesa personale lidhur marrëveshjen e koncesionit, që sjellin si pasojë ekzistencën e konfliktit të interesit, për shkak të të cilit nuk duhet të marrë pjesë në mbledhje. Komisioni për Ekonominë dhe Financat ka respektuar me korrektësi të gjitha detyrimet e përcaktuara në Kushtetutë dhe në Rregulloren e Kuvendit gjatë gjithë procesit të shqyrtimit të këtij projektligji.

\* \* \*

Znj. Belinda Balluku, Ministre e Infrastrukturës dhe Energjisë, paraqiti mendimin e kësaj ministrie kundër dekretit të Presidentit të Republikës. Ajo theksoi se marrëveshja e koncesionit është lidhur me shoqërinë koncesionare dhe nuk ndikohet nga ndryshimi i koncesionarit. Kjo marrëveshje nuk duhet të trajtohet si marrëveshje ndërkombëtare. Marrëveshja ndryshuese e koncesionit është në përputhje me Planin Strategjik për Zhvillimin e Aviacionit Civil, të prezantuar në shtator 2019. Plani strategjik ka objektiva krijimin e kushteve për shërbime më cilësore të aviacionit civil shqiptar dhe ulje të çmimeve. Këto objektiva janë akomoduar përmes rinegociimit të marrëveshjes së koncesionit.

Parashikimi i investimeve në vlerën 99.3 milionë euro do të shërbejë për rritjen e kapacitetit përpunues të aeroportit, rritjen e numrit të avionëve, rritjen e konkurrencës brenda shoqërisë së aviacionit civil, duke ndikuar në uljen e çmimit dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve. Marrëveshja ndryshuese e koncesionit nuk ka asnjë kundërshti me MSA-në.

\* \* \*

Znj. Vasilika Vjero, Zëvendësministre e Financave, informoi Komisionin lidhur me procedurat për hartimin dhe negocimin e marrëveshjes, të nisura në fillim të vitit 2020, si dhe mbështetjen e të gjithë procesit nga Avokatura e Shtetit. Ajo theksoi se marrëveshja ndryshuese e koncesionit nuk ka implikime fiskale për shpenzimet buxhetore, deficitin buxhetor dhe borxhin publik, pasi nuk është me mbështetje buxhetore direkte apo indirekte. Investimet do të kryhen me shpenzimet e koncesionarit dhe do të sjellin rritjen e kategorisë së aeroportit, si dhe akomodimin e një numri më të madh pasagjerësh. Investimi parashikohet të jetë i qëndrueshëm, pasi nuk kërkon mbështetje buxhetore. Pjesa më e madhe e risqeve janë marrë përsipër nga partneri privat dhe nuk kërkohet garanci nga shteti.

\* \* \*

### **Argumente të detajuara lidhur me dekretin e Presidentit të Republikës.**

Argumentet e detajuara të Komisionit për Ekonominë dhe Financat, për secilin prej pretendimeve të paraqitura në arsyetimin e dekretit, janë si më poshtë:

➤ ***Lidhur me pretendimin se negociimi me shoqërinë koncesionare dhe miratimi i shtesës së kontratës koncesionare është miratuar me urgjencë dhe shpejtësi***, Komisioni është i mendimit se:

Ky proces është zhvilluar në mënyrë korrekte dhe ligjore. Kërkesat për negociim janë iniciuar nga përfaqësuesit e Organit Shtetëror të Autorizuar (Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë) që në fillimin e vitit 2020. Këto negociata u ndërprejnë për shkak të situatës së krijuar nga pandemia Covid-19.

Në muajin dhjetor 2020, shoqëria koncesionare ka paraqitur kërkesën për vijimin e negociatave, me qëllim zbatimin efektiv të marrëveshjes së koncesionit, si dhe zgjidhjen e një sërë çështjesh dhe problematikash, të mbartura nga aksionarët e mëparshëm, në lidhje me këtë marrëveshje.

Në vijim të kësaj kërkese, nga ana e OSHA, me anë të Urdhrit nr. 8 datë 12.1.2021 “Mbi ngritjen e grupit të punës për negocimin e kontratës së koncesionit të Aeroportit Ndërkombëtar “Nënë Tereza”, grupi i punës vijoi punën në muajin janar 2021 me zhvillimin e negociatave me shoqërinë zotëruese të kontratës koncesionare, shoqërinë “Kastrati Group” sh.a, negociata të cilat u finalizuan në datën 22.1.2021 me përgatitjen e Raportit të Negociatave për OSHA. Pas miratimit të këtij raporti nga OSHA, është proceduar me hartimin e marrëveshjes ndryshuese, e cila në mbështetje të pikës 3.2 të nenit 3 dhe nenit 38 të marrëveshjes së koncesionit, është noterizuar përpara një noteri publik.

Që nga ngritja e grupit të punës, deri në finalizimin e raportit të negociatave për OSHA-në, kjo procedurë është ndjekur dhe asistuar në të gjithë periudhën e negociatave dhe pas saj nga institucioni i Avokaturës së Shtetit. Ky institucion, në zbatim të ligjit nr.10018 datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, të ndryshuar, pjesë e grupit të punës për negocimin e kontratës koncesionare, ka asistuar dhe këshilluar grupin e punës në lidhje me negocimin e kontratës së koncesionit, si dhe në të gjitha diskutimet dhe materialet e administruara prej tij.

Pas miratimit të raportit të grupit negociator të punës nga titullarët e OSHA-së, draft marrëveshja i është dërguar për miratim paraprak Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Avokaturës së Shtetit, për të konfirmuar ligjshmërinë e draft marrëveshjes dhe të procedurës së

ndjekur nga OSHA. OSHA, përmes shkresës nr.355/1 prot., datë 25.01.2021 shprehet se në lidhje me ndryshimet e propozuara për ndryshimin e kontratës së koncesionit ka siguruar në vijimësi asistencën ligjore në përputhje me funksionin e saj këshillimor.

➤ ***Lidhur me pretendimin se shtesa e kontratës përpara noterit në Kamëz është në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”, Komisioni është i mendimit se:***

Nënshkrimi i shtesës së kontratës është bërë në përputhje të plotë me përcaktimet e nenit 20 të ligjit nr.110/2018 “Për noterinë”, sipas të cilit:

*“Noteri licenohet për të ushtruar veprimtarinë në një bashki të caktuar. Noteri mund të ketë vetëm një zyrë noteriale në territorin e bashkisë ku ofron shërbime noteriale. Noteri nuk mund të hartojë akte ose të kryejë veprime noteriale jashtë kësaj bashkie, me përjashtim të rasteve të parashikuara në ligj. **Noteri mund të kryejë shërbime në zyrën e tij noteriale për veprime e pasuri që ndodhen në një bashki tjetër, kur palët paraqiten dhe kërkojnë ta kryejnë shërbimin në zyrën noteriale. Hartimi i akteve dhe kryeja e veprimeve noteriale nga noteri jashtë territorit të përcaktuar për ushtrimin e veprimtarisë se tij nuk sjell pavlefshmërinë tyre.**”*

➤ ***Lidhur me pretendimin se procedura e ndjekur bie në kundërshtim me parashikimet e Kodit Zgjedhor dhe aktet e dala në zbatim të tij, Komisioni është i mendimit se:***

Pretendimi nuk qëndron dhe është i pabazuar. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në cilësinë e anëtarit të OSHA, ka marrë miratimin nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me anë të shkresës nr. 600/1 prot, datë 26.01.2021. KQZ i është referuar vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”. Në pikën 4 të nenit 3 të këtij vendimi, mbi veprimtaritë e ndaluara, përcaktohet se: “**Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve, ndalohet dhënia e kontratave publike të koncensionit/partneritet publik privat (PPP), për të cilat nuk është bërë njoftim publik se do të zhvillohen, nuk janë vijim i një procedure koncensionare të identifikuar dhe nisur, apo nuk janë parashikuar për t’u financuar nëpërmjet buxhetit të miratuar të vitit zgjedhor**”. **Ky vendim nuk ndalon asnjë veprimtari, që lidhet me një marrëdhënie koncensionare, të krijuar përpara hyrjes në fuqi të tij, siç është rasti i ndryshimit të marrëveshjes së koncesionit për Aeroportin “Nënë Tereza”.**

➤ ***Lidhur me pretendimin se zgjatja e afatit të kontratës përbën ndryshim të një kushti thelbësor të kontratës bazë dhe kërkon kryerjen e një procedure të re të dhënies me koncesion, Komisioni është i mendimit se:***

Ky pretendim është tërësisht i pabazuar, si në kuadrin ligjor aktual për koncesionet/PPP në fuqi, ashtu edhe në marrëveshjen e koncesionit “Për ndërtimin, vënien në punë, operimin dhe



mirëmbajtjen e aeroportit ndërkombëtar “Nënë Tereza”, Tiranë” , të ratifikuar me ligjin nr.9312 datë 11.11.2004, të ndryshuar.

Ligji nr.125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar, parashikon se afati kohor i kontratës mund të zgjatet nëse është e nevojshme, për shkak të ndryshimeve të kontratës. Ndryshimet në kontratë mund të bëhen me iniciativën e të dyja palëve kontraktuese dhe një nga rastet e parashikuara për ndryshimin e afatit është “*në raste të tjera që çojnë në ndryshimin e situatës reale ose ligjore për përdorimin e objektit apo ofrimin e shërbimeve ose në realizimin e kontratës.*”. “*Ndryshimet e kushteve thelbësore të kontratës, që nuk parashikohen në dokumentacionin e tenderit dhe/ose në vetë kontratën, kërkojnë zbatimin e një procedure të re të dhënies së kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat.*”

Ndryshimi i afatit kontratës, në aspektin ligjor, është bërë në përputhje të plotë me legjislacionin e zbatueshëm. Rregullimi dhe zbatimi i kësaj kontrate është përcaktuar në ligjin nr. 9312, datë 11.11.2004, që ka miratuar kontratën bazë. Kjo kontratë, në pikën 2.2 të nenit 2, përcakton se:

*“a) Koncesioni jepet për 20 vjet, që fillon të llogaritet nga Data e Fillimit (“Afati i Koncesionit”).*

*Afati i Koncesionit mund të zgjatet:*

- i) me marrëveshje me shkrim të palëve (për një afat të lejuar nga Ligji i Zbatueshëm);*
- ii) me afatin e Forcës Madhore, që është mbi 2 muaj, në përputhje me pikën 24.5; ose*
- iii) për aq kohë sa kërkon kryerja e Ndryshimeve të Pranueshme.*

*b) Organi Shtetëror i Autorizuar dhe Shoqëria, duke njoftuar me shkrim njëra tjetrën, pas 5 vjetëve nga Data e Fillimit por jo më vonë se 12 muaj para mbarimit të Afatit të Koncesionit, fillojnë procesin e negociimit për zgjatjen e afatit fillestar të Koncesionit.”*

Pra, sipas këtij përcaktimi, është tërësisht e qartë se zgjatja e afatit është ligjërisht e lejuar dhe e parashikuar në kontratën bazë.

Ndryshimi i propozuar i afatit nuk ka tejkalluar objektin e kontratës, sepse shërbimet që do të vijonë të ofrohen janë të njëjtat, detyrimet e shoqërisë të përcaktuara në kontratën bazë, mbeten të paprekura dhe nuk përfshihen elementë të rinj, të cilët nuk kanë qenë të parashikuar në dokumentet e tenderit, projektin dhe objektin e kontratës fillestare. Kontrata ndryshuese parashikon të njëjtat shërbime, të cilat synohen të ofrohen në zbatim të planit të ri të biznesit dhe masterplanit të ri të shoqërisë koncesionare, me një cilësi shumë herë më të përmirësuar, ku vlen të theksohet: rritja e performancës, shtimi i kapaciteteve dhe investimeve, modernizimi i shërbimit në vëmendje të rritjes së interesit publik, ulja e kostove për përdoruesit, si dhe zbatimi i kësaj kontrate me rëndësi kombëtare me efikasitet dhe efektivitet.

Ligji nr.125/2013, i ndryshuar, e ka parashikuar afatin si një element që mund të ndryshohet dhe zgjatet dhe jo si kusht thelbësor, për të cilin palët do të detyroheshin të bënin një procedurë të re.

Zgjatja e afatit të kontratës me 13 vjet e çon afatin total të koncesionit nga 22 vjet, në 35 vjet, aq sa lejohet nga ligji i zbatueshëm i koncesioneve nr.125/2013.

Në pikën 2.2 të nenit 2 të marrëveshjes bazë të koncesionit përcaktohet se: “*Afati i Koncesionit mund të zgjatet: i) me marrëveshje me shkrim të palëve (për një afat të lejuar nga Ligji i*

Zbatueshëm)”. Kjo teknikë legjislative në formulimin e kësaj pike të marrëveshjes mes palëve është e njëjtë me teknikën legjislative të ndjekur edhe për ndryshimet e tjera të kësaj marrëveshjeje koncesionare, ku afati ka qenë pjesë e ndryshimit në raport me afatin fillestar të marrëveshjes koncesionare.

Për sa më sipër, konkludohet se zgjatja e afatit është bërë në përputhje të plotë me ligjin nr. 9312 datë 11.11.2004, si baza ligjore e detyruar për t’u zbatuar si dhe me frymën e ligjit aktual të koncesioneve dhe partneritetit publik privat.

➤ ***Lidhur me pretendimin se ky ndryshim nuk i është nënshtruar një analize ligjore, financiare dhe ekonomike, Komisioni është i mendimit se:***

Analiza ligjore, financiare dhe ekonomike ka qenë pjesë e procesit të negocimit midis palëve. Vlerësimi i ndryshimit të kontratës është bazuar në analizat e detajuara nga të gjithë aktorët e përfshirë në këtë proces. Bazuar në këto analiza, OSHA ka mbështetur ndryshimin e kontratës. Në vijim, OSHA ka ezuaruar më tej të gjitha hapat proceduriale për përcjelljen e miratimit të këtij ndryshimi në Këshillin e Ministrave, i cili ka vijuar me procedurën ligjore.

Ndryshimi i kontratës synon të sjellë një sërë përfitimesh si për shtetin, ashtu edhe për shtetasit shqiptarë, si dhe për çdo përdorues të këtij aeroporti, duke renditur si më poshtë:

- Përmirësimin e pozitës ekonomike të koncensionit, të shtrirë në vitet e ardhshme, sipas propozimit të shoqërisë.
- Kryerjen e një investimi në vlerën rreth 99 milionë euro, duke ulur njëkohësisht tarifat për pasagjerët, në një situatë kur projeksionet e trafikut dhe të ardhurat prej tyre do të jenë ndjeshëm më të ulëta, për shkak të ndikimit në këtë sektor të pandemisë Covid-19 dhe që pritet të rikuperohen e të kthehen në trendet e mëparshme vetëm pas vitit 2025.
- Inicimin e një praktike të re gjatë implementimit të kësaj kontrate koncensionare, atë të uljes së tarifës me 20 për qind për të rriturit dhe 40 për qind për fëmijët;
- Lirinë e hyrjes në tregun e shërbimeve në tokë, e cila pasohet me mundësimin e hyrjes së operatorëve të tjerë për ofrimin e këtyre shërbimeve. Kjo masë do të ndikojë direkt në tarifat aeroportuale, duke hequr ekskluzivitetin për vendosjen e këtyre tarifave nga koncensionari.
- Përfitimet në lidhje me një aset, të cilin momentalisht shteti shqiptar nuk është në pozitën më të mirë për ta menaxhuar vetë. Ndër përfitimet, vlen të përmendim rritjen ekonomike, rritjen e punësimit, zhvillimin e turizmit, përfitimet ekonomike të shtetit, si rrjedhojë e pjesëmarrjes së tij në pjesën prej 30 për qind të fitimit që shpërndan kompania dhe përfitimit nga taksat e aeroportit, si dhe marrjen në përfundim të kontratës të një asemi modern, të mirëmbajtur dhe të rinovuar.
- Pas realizimit të investimeve të parashikuara nga shoqëria e re aksionare, aeroporti do të jetë i kategorisë 4E, duke bërë të mundur për herë të parë lidhjen direkte me shtete, të

cilat janë konsideruar strategjike për zhvillimin e ekonomisë së vendit. Ky investim do të jetë një biznes funksional, përveç se një aset strategjik, si dhe do të shërbejë si një faktor kyç ndërlidhës i biznesit dhe investimeve të huaja, ashtu siç përmendet edhe në studimin ekonomik-financiar të koncesionarit.

Të gjitha këto krijojnë bindjen për zbatimin efektiv të kësaj kontrate, produktivitetin e negociatave dhe përfitueshmërinë nga ndryshimi i kontratës.

➤ *Lidhur me pretendimin se zgjatja e afatit të kontratës koncesionare është bërë pa një analizë mbi seriozitetin, aftësinë menaxhuese dhe qëndrueshmërinë financiare të shoqërisë që ka blerë aksionet e infrastrukturës së vetme funksionale aeroportuale ndërkombëtare në vend*, Komisioni është i mendimit se:

Ky pretendim nuk qëndron, pasi shoqëria e re aksionare ka plotësuar të gjitha kriteret financiare dhe teknike lidhur me marrjen në kontroll të shoqërisë koncesionare “Tirana Airport Partners” sh.p.k dhe ka marrë përsipër të përmbushë të gjitha detyrimet që përcakton kontrata bazë e koncesionit. Për sa i përket aftësisë menaxhuese, ndryshimi i aksionarit nuk është shoqëruar me ndryshimin e stafit menaxherial dhe teknik të aeroportit.

Procedura e ndjekur, lidhur me këtë ndryshim, ka kaluar në të gjitha institucionet e përcaktuara me ligj.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, për vlerësim dhe miratim paraprak, ndryshimin e kontratës, sipas përcaktimeve të nenit 10 të ligjit nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat” të ndryshuar.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka bërë vlerësimin e këtij ndryshimi nga të gjitha strukturat e saj përgjegjëse, sipas kërkesave të ligjit nr 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e shqipërisë”, të ndryshuar, lidhur me:

- a) Implikimet fiskale, individuale apo në grup, për shpenzimet buxhetore;
- b) Deficitin buxhetor;
- c) Qëndrueshmërinë e borxhit publik;
- ç) Detyrimet kontingjente eventuale.

Mbi bazën e analizës së kryer, kjo ministri ka konstatuar se:

- Ndryshimi i marrëveshjes nuk shoqërohet me efekte financiare në buxhetin e shtetit, pasi nuk kërkohet mbështetje financiare direkte apo indirekte.
- Lidhur me përballueshmërinë e projektit, konstatohet se marrëveshja ndryshuese synon kryerjen e investimeve shtesë në aeroport për rritjen e kategorisë së tij dhe akomodimin e një trafiku më të madh pasagjerësh. Këto investime do të kryhen tërësisht me financimin e shoqërisë koncesionare dhe në këtë mënyrë nuk ndikojnë në përballueshmërinë e projektit.
- Lidhur me qëndrueshmërinë e projektit, në studimin ekonomik-financiar të përgatitur nga shoqëria koncesionare dhe të vlerësuar nga grupi negociator, është argumentuar se

ky projekt është i qëndrueshëm dhe se nuk kërkohet asnjë lloj mbështetjeje financiare për implementimin e objektit të këtij ndryshimi të marrëveshjes së koncesionit.

- Lidhur me analizën e risqeve, konstatohet se pjesa më e madhe e risqeve janë marrë përsipër nga partneri privat, ku ndër më kryesori është risku i kërkesës që impakton zakonisht projektet e kësaj fushe, për të cilin nga shteti nuk kërkohet asnjë lloj garancie, por edhe në lidhje me risqet që janë marrë përsipër ose janë ndarë me partnerin publik referuar parashikimeve të analizës së risqeve nuk konstatohet që buxheti i shtetit ngarkohet me ndonjë kosto financiare.

Për sa më sipër, Ministria e Financave dhe Ekonomisë është shprehur parimisht dakord në lidhje me këtë ndryshim të marrëveshjes, për sa kohë që ai nuk cenon qëndrueshmërinë dhe përbalueshmërinë e projektit dhe nuk shoqërohet me ndonjë kosto shtesë për buxhetin e shtetit.

➤ ***Lidhur me pretendimin se zgjatja e afatit të kontratës koncesionare nuk ka marrë në analizë objektive interesin publik lidhur me sigurinë kombëtare***, Komisioni është i mendimit se:

Ky pretendim nuk qëndron, pasi institucionet përgjegjëse lidhur me këtë çështje si Ministria e Brendshme dhe Ministria e Mbrojtjes e kanë shprehur qëndrimin e tyre, i cili është pjesë përbërëse e kësaj procedure, si dhe përdoruesit e këtij shërbimi do të kenë përfitime të konsiderueshme prej këtij ndryshimi si në cilësinë e ofruar, ashtu edhe në tarifatat që do të paguajnë për shërbimin.

➤ ***Lidhur me pretendimin se vendosja përmes ligjit, e autorizimit për marrjen e huave duke lënë kolateral aksionet e shoqërisë, e vë para një rreziku të shtuar potencial të gjithë funksionimin e këtij shërbimi, përkundrejt sigurisë kombëtare***, Komisioni është i mendimit se:

Kjo e drejtë jo vetëm që nuk është e ndaluar nga ligji i koncesioneve në vendin tonë, por është e njohur edhe nga praktika ndërkombëtare. Në kontratat e koncesioneve mund t'i jepet e drejta palës koncesionare që të përdorë objektin/asetet e koncesionit si garanci apo kolateral për marrjen e huave, vetëm me qëllim zbatimin e kontratës koncesionare.

Marrja e huasë lidhet vetëm me qëllimin e zbatimit të kësaj kontrate. Megjithatë, marrëveshja e koncesionit parashikon edhe një mekanizëm mbrojtës lidhur me këtë hua, që është risku i transferimit të aseteve, si rezultat i përfundimit apo ndërprerjes së kontratës.

Ky risk reflektohet në nenin 29 “Dorëzimi” pika (c) të kontratës së koncesionit, ku parashikohet se: *“Qeveria e Shqipërisë nuk është përgjegjëse për asnjë detyrim, hua, kapital ose obligacion tjetër të Shoqërisë në lidhje me funksionimin dhe administrimin e Aeroportit apo për shkak të fitimit apo kalimit të aktiveve, pronave, të drejtave dhe detyrimeve të ndryshme të referuara në këtë pikë nga dhe tek Qeveria e Shqipërisë, ose në një formë tjetër”*. Sipas këtij përcaktimi, ky

risk është marrë përsipër tërësisht nga koncesionari, i cili është i detyruar ta dorëzojë objektin tek Qeveria e Shqipërisë të pastër, pa asnjë detyrim apo obligacion.

Ndërsa në rastin e lindjes së çdo situatë apo problemi, siç mund të jetë edhe paaftësia paguese e palës koncesionare, që mund të derivojë si rezultat i huave mbi objektin, nuk e cenon në asnjë moment funksionimin e shërbimit, pasi përveç garantimit të marrjes së objektit të zhveshur tërësisht nga detyrimet e koncesionarit, kontrata e koncesionit ka parashikuar dhe i ka dhënë zgjidhje edhe kësaj pike në nenin 32.2, ku është parashikuar Zëvendësimi nga Qeveria e Shqipërisë si më poshtë:

*“(a)Atehere kur do të shihet e nevojshme që Qeveria Shqiptare, për qëllim të kësaj Pike 32.2 (Zëvendësimi nga Qeveria Shqiptare) mund të caktojë një shoqëri në pronësi të plotë të Qeverisë Shqiptare për të zëvendësuar shoqërinë, që do të sillet si Shoqëria në këtë Kontrate (“Subjekti Zëvendësues”).*

*(b)Nëse Qeverisë së Shqipërisë i lind e drejta e zgjidhjes së kësaj Kontrate dhe Huadhënësi nuk ve në zbatim kontratën që rregullon të drejtën e ndërhyrjes se Huadhënësit në përputhje dhe brenda afatit të caktuar në pikën 26.3 (Zgjidhja nga Qeveria e Shqipërisë në Rastin e Veçantë të Mospërmbushjes nga Shoqëria), Qeveria e Shqipërisë ka të drejtë që pas lajmërimit me shkrim të Shoqërisë dhe Huadhënësit, të zëvendësojë Shoqërinë me Subjektin Zëvendësues.”*

Për më tepër, që ky parashikim është një përmirësim nga kontrata bazë, që përcaktonte se *“Shoqëria do të lejohet të vendosë Barrë Siguruese mbi Uzufuktin e dhënë në lidhje me Zonën e Koncesionit, Terminalin Ekzistues, Aktivitetin e Lidhura dhe Shtesa të Uzufuktit në përputhje me Ligjin e Zbatueshëm”* dhe që *“Shoqëria do të ketë mundësinë të krijojë Barrë Siguruese mbi Ndertimet e Reja, në përputhje me këtë Kontratë dhe Ligjin e Zbatueshëm”* .

**➤ Lidhur me pretendimin se kjo marrëveshje duhet të përfshinte në klauzolat e saj ndalimin e shoqërisë koncesionare, të parashikuar në marrëveshje apo të një shoqërie tjetër të lidhur me të, direkt a indirekt, për të konkurruar dhe fituar të drejta të tjera koncesionare, me qëllim shmangien e pozitës dominuese, Komisioni është i mendimit se:**

Çështjet që lidhen me konkurrencën janë objekt vlerësimi i Autoritetit të Konkurrencës, i cili me anë të Vendimit nr.755 datë 9.12.2020 *“Mbi autorizimin e përqëndrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë Tirana International Airport sh.p.k nga Kastrati Group sh.a”*, pas analizës së këtij transaksioni ka vendosur ta autorizojë këtë përqëndrim të realizuar, duke u shprehur mbi efektet që do të ketë në treg ky përqëndrim, si më poshtë:

*“Transaksioni konsiston në një ndryshim kontrolli të tregut. Blerësi është i pranishëm në tregun e brendshëm.*

*Transaksioni nuk do të ketë as mbivendosje horizontale, as vertikale midis ndërmarrjeve përkatëse, dhe për rrjedhojë nuk do të ketë as rritje të pjesës së tregut ose ndryshim të tregut përkatës pas realizimit të transaksionit.*

*Transaksioni nuk do të rezultojë në ndonjë rritje të pjesës së tregut, pasi TIA do të vazhdojë të drejtohet në përputhje me kushtet e kontratës së koncesionit, e cila përcakton qëllimin, metodën*

*dhe bazën e shërbimeve që do të ofrohen.*

*Ndërmarrja objekt përqëndrimi Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës zotëron pozitë dominuese në tregun përkatës, pasi ka ekskluzivitetin “de facto” të fluturimeve ndërkombëtare drejt/nga Shqipëria dhe ekziston rreziku i abuzimit me pozitën dominuese sipas nenit 9 të Ligjit nr.9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar.*

*Për këtë arsye, Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës duhet të zbatojë kushte të barabarta për veprime të njëjta tregtare me palët që do të operojnë në këtë aeroport (shoqëritë ajrore, përfshirë dhe ato me kosto të ulët (low cost).*

*Si konkluzion, përqëndrimi i realizuar nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.”*

#### **IV. Përfundim.**

Mbështetur në argumentet e mësipërme, të cilat në mënyrë të përmbledhur janë:

- Projektligji është në përputhje me kushtetutën dhe legjisllacionin në fuqi;
- Procedura e shqyrtimit të projektligjit është në përputhje me Rregulloren e Kuvendit;
- Zgjatja e afatit të koncesionit është një e drejtë e lejuar nga legjisllacioni në fuqi për koncesionet dhe partneritetin publik privat dhe kontrata bazë e koncesionit;
- Marrëveshja ndryshuese mbështetet në analizat ligjore, financiare dhe ekonomike, të kryera nga të gjitha palët e përfshira në proces, të cilat kanë argumentuar qëndrueshmërinë financiare të shoqërisë koncesionare dhe të investimit që ajo ka marrë përsipër, mbrojtjen e interesit publik dhe ruajtjen e sigurisë kombëtare;
- Autoriteti i Konkurrencës ka vlerësuar se marrëveshja e koncesionit nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të veçantë të tij;

Komisioni nuk e miratoi dekretin e Presidentit të Republikës me të gjitha votat kundër të anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

**KRYETARI**

**Anastas ANGJELI**